



LAJMËTARI I RADIO MARIËSË



Organ i Radio Marisë Viti I. Nr. 1 Janar 2009

PËR SHUMË VJET KËRSHENDELLAT DHE VITIN E RI 2009

Radio Maria Shqiptare
Hiri i Hyjit në shtëpinë

EDITORIAL

Të dashur miq dhe dëgjues të Radio Marisë

Tashmë kaluan më shumë se pesë vite që po hamendemi për të ndërmarrë edhe një hap të ri në jetën e Radio Marisë.

Shën Pali, 2000 vjetorin e lindjes së të cilit po e kremton Kisha, dhe Jezu Krishti që po vjen na falën edhe një dhuratë, «Lajmëtarin e Radio Marisë». Shpresojmë që në vitin 2009 do të na dhurojë edhe ndërtesën e re të Radio Marisë në Tiranë. Në Vitin 2009 kërkojmë nga Zoja e Bekuar të na i dhurojë frekuencat kombëtare dhe frekuencat e Radio Marisë në Kosovë.

Dëshirojmë ta falënderojmë Jezusin që bekoji gjatë këtyre viteve punën tonë, falënderojmë bamirësit tanë të shumtë në Shqipëri dhe nëpër botë, falënderojmë Familjen Botërore të Radio Marisë e cila përmes Radiove kombëtare bashkon në lutje dhe falënderim të gjithë besimtarët në të katër anët e botës.

Në këto vite kanë ndodhur aq shumë gjëra, të cilat është e pamundur t'i kujtojmë në këtë

numër, por që nga sot «Lajmëtarin e Radio Marisë» do të përcjellë të gjitha ngjarjet që të gjithë së bashku ta kemi më të qartë rritjen tonë si familje.

Radio Maria e ka për qëllim që Fjala e Hyjit të arrijë secilin njeri. Kjo fjalë mbartë në vetvete porosinë e dashurisë, të paqes, të pranimit të ndërsjellët të të gjithë njerëzve. Radio Maria dëshiron t'i bashkojë njerëzit në vëllazëri të vërtetë duke përhapur bashkimin më të gjithë, dëshiron të sjellë në zemër të secilit vlerat e vërteta dhe të pakalueshme që janë vlerat shpirtërore. Radio Maria është për të gjithë njerëzit çfarë është për të gjithë njerëzit Biri i saj Jezu Krishti.

Pa dashur ta zgjas duke i uruar jetë të gjatë «Lajmëtarit të Radio Marisë» në emër të të gjithë bamirësve, të të gjithë dëgjuesve, të të gjithë bashkëpunëtorëve, të gjithëve ju uroj festën e Kërshëndellave dhe Vitin e Ri 2009.

I juaj

don Prekë Lazraj

Në këtë numër do të gjeni.

Editorial	fq. 1
Veprimtaritë e Radio Marisë	fq. 2
Këndi i fëmijve	fq. 2
Programi	fq. 3
Frekuencat e Radio Marisë	fq. 4
Si të jemi mirënjohës	fq. 4
Lurdi 1858 - 2008	fq. 4
Si mund të ndihmoni Radio Marinë	fq. 4
Viti i Shën Palit 29.06. 2008 - 29.06.2009	fq. 4



Veprimtaritë e Radio Marisë Shqiptare

-Veprimtaritë e Radio Marisë janë të shumta por gjatë viteve që po lëmë pas veçojmë: transmetimet e drejtpërdrejta të veprimtarive të Kishës Katolike në Shqipëri. Janë transmetuar Meshët në rastet e shugurimeve të meshtarëve dhe diakonëve, në marrjen e kushteve nga motrat e kongregatave të ndryshme. Ka marrë pjesë në shugurimet e Katedraleve dhe Kishave, në festa të ndryshme, në vizita baritore dhe kremtime të tjera.

-Çdo të diele nga ora 20⁰⁰ -21³⁰ bëhet lidhja e drejtpërdrejt me Radion Katolike të Miçigan me qendër në Detroit. Zoti nëpërmjet kësaj lidhjeje ka bërë që vëllezërit dhe motrat tona në kontinentin e Amerikës, por edhe të kontinenteve të tjera, të jenë të lidhur edhe më shumë jo vetëm me Radio Marinë por edhe me vendin e tyre. Falënderojmë bashkëpunëtorët të cilët e mundësojnë këtë lidhje nga Detroiti. Don Ndoun dhe Don Antonin, Martinin, Aleksandrin, Ildën, Luigjin, Valentinin etj.

-Me datën 14-18 Nëntor 2008 në Tiranë u zhvillua Panairi i Librit 2008. Në këtë panair për herë të parë mori pjesë dhe

Radio Maria Shqiptare në bashkëpunim me Shtëpinë e librit katolik «Genizah». Në panair Radio Maria u përfaqësua me disa nga botimet e saj si: me librin «Pali i Tarsit vigani i krishterimit», DVD, CD dhe kasetat. Tek stenda e Radio Marisë vizitorët kanë qenë të shumtë dhe krahas interesimit të tyre për të blerë librin dhe CD-të ata shprehnin falënderimet në radhë të parë ndaj Zotit, duke e quajtur Radio Marinë dhuratë që Zoti ia ka bërë popullit Shqiptar. Falënderimi i dytë ishte për stafin e radios për punën e mirë që ka bërë gjatë 5 viteve jetë kjo radio. Të bënte përshtypje se vizitorët ishin të besimeve, moshave, profesioneve dhe vendeve të ndryshme. Falënderojmë përfaqësuesit e shtëpisë së librit «Genizah» Regjinën dhe Julien për kujdesin vëllazëror që treguan ndaj nesh.

- Më 28 -29. nëntor 2008 patëm «Dy ditët e Radio Marisë», ishim në programet e përbashkëta me më se 53 Radio Mari që veprojnë në botë. Falënderojmë Zotin për gjithçka. (Roza)

☺ KËNDI I FËMIJËVE ☺

Radio Maria i lë një vend të veçantë fëmijëve me emisionin e tyre të përditshëm nga ora 19.00 -19.30 dhe për këtë nismë angazhohen 12 fëmijë dhe të rinj të moshave të ndryshme të cilët në mënyrë të pavarur dhe me plot entuziazëm e përgatisin emisionin e tyre.

Për t'u përgatitur sa më mirë për Krishtlindje, bashkë me dëgjuesit tanë të vegjël, kemi ndërtuar "Qytetin për Jezusin" të ilustruar në letër, duke e vizatuar ashtu siç është imagjinuar ky qytet prej secilit fëmijë dhe duke e jetuar jetën brenda këtij "qyteti të virtytshëm". Për çdo ditë jemi munduar ta jetojmë në të përditshmen tonë nga një virtyt duke ndërtuar për çdo ditë nga një "shtëpi virtyt" duke krijuar kështu një strehë të fortë për Jezusin fëmijë.

Marinela dhe Mario gjatë javës së parë të Ardhjes na ndihmuan të ndërtojmë shtëpinë e dashurisë, durimit, punës, dëgjesës dhe të lutjes.

Në javën e dytë Adela dhe Rosela na ndihmuan të ndërtojmë shtëpinë e paqes, buzëqeshjes, gëzimit, faljes dhe sinqeritetit.

Javën e tretë na shoqëruan Dileta dhe Armando, të cilët vazhduan ndërtimin e qytetit të Jezusit duke ndërtuar shtëpinë e miqësisë, pastërtisë, ndihmës dhe heshtjes.

Javën e katërt Andrea dhe Paskualina ia shtuan shtëpitë e fundit qytetit me ndërtimin e shtëpisë së lirisë, lëmshës dhe të librit.

Dita e shumëpritur erdhi... Krishti lindi për ne, por ne nuk kemi pse të shqetësohemi të dashur fëmijë, apo jo? Së bashku kemi ndërtuar një qytet të tërë për Jezusin e vogël. Një qytet,

në të cilin banorët punojnë, luten, janë të durueshëm ndaj njëri tjetrit, janë të dëgjueshëm, jetojnë në paqe sepse kanë gjithmonë buzëqeshje për t'i dhuruar tjetrit. Këtë qytet e karakterizon gëzimi sepse banorët e tij e dinë rëndësinë e faljes, dinë të falin dhe të kërkojnë falje, janë të sinqertë dhe mbesin gjithmonë miq të mirë edhe pse mund të kalojnë një mal të vështirësive sepse janë të pastër në zemër dhe plot shpresë për një të ardhme të ndritur. Ne e dimë se nuk na mungon ndihma e të afërmeve sepse megjithëse janë të heshtur, veprojnë në liri të plotë duke u dhënë lëmshë atyre që kanë nevojë, të gjithë janë të arsimuar, të ditur, pasi kanë mësuar mirë në shkollë sepse e dinë vlerën e librit. Ky qytet është vërtetë i bekuar sepse karakterizohet mbi të gjitha nga virtyti kryesor që është Dashuria të cilën këta banorë të vegjël e ndjejnë në zemrën e tyre...

Ne, të gjithë drejtuesit e emisionit për fëmijë, ju urojmë Krishtlindje të bekuara dhe hire e bekime gjatë Vitit 2009 të dashur fëmijë. (Linda)



<u>Programi bazë i ditës</u>		<u>Programet e orës 20⁰⁰</u>	
00 ⁰⁰	Rruzarja me Atin e shenjtë Benediktin e XVI sipas ditës përkatëse	<u>E hënë:</u>	Magjisteri i Kishës, Ati i shenjtë për Shën Palin – Don Preka; Familja Kishë shtëpiake – Don Gjovali Simoni
00 ³⁰	Leximi i Besëlidhjes së Re – Don Preka	<u>E marte:</u>	Misteri i Hyjit në lutjen e Kishës – Don Dominiku; Dora e ngrohtë e familjes – Roza; Një vulë në histori – Linda & Edisoni
01 ⁰⁰	<u>(Shiko emisionet e natës sipas ditës përkatëse)</u>	<u>E mërkure:</u>	Të rinjtë kërkojnë thesarin - Motër Miki; Të shfaqurat e Zojës , Majlinda; Personazhe që duhen kujtuar - Florenci
02 ⁰⁰	Rruzarja misteret e dritës	<u>E enjte:</u>	Ne jemi mrekullia e Zotit – Motër Arta; Njeriu Pyet – Jolanda
02 ³⁰	R. Leximit të librit	<u>E premte:</u>	Zoti flet e ne dëgjojmë – Don Mark Shtjefni; Fjala për të jetuar - Fokolarinët; Sakramentet mjet shëlbimi si dhe përse?- Orselina; Besoj shpjegimi i simbolit të fesë sonë - Orselina
03 ⁰⁰	Rruzarja misteret e mundimit	<u>E shtunë:</u>	Shpjegimi i fjalës së Zotit e cila na përgatit për të dielën – Don Preka; Meshtari dëgjon të rinjtë - Don Dominiku (ora 22)
04 ⁰⁰	<u>(Shiko meditimet sipas ditës përkatëse)</u>		Hap pas hapi në jetë – Domenika
05 ⁰⁰	Rruzarja misteret e Lumturisë, Leximi i Besëlidhjes së Re – Don Preka	<u>E dielë:</u>	Në udhëtim me Krishtin drejtë për së drejti me radion Katolike Detroit
05 ³⁰	365 Historitë e biblës - Antonio dhe Paola		<u>Emisionet që ritransmetohen në oraret e natës</u>
06 ¹⁵	Leximi meditativ i librit të përngjamët e Krishtit.	<u>E dielë</u>	
06 ³⁰	Ta fillojmë ditën me Jezusin paraqitja e shenjtit të ditës	0100	(R. Programi i të Hënës) Magjisteri i Kishës, Ati i shenjtë për Shën Palin – Don Preka; Familja kishë shtëpiake – Don Gjovali Simoni
07 ⁰⁰	Paraqitja e njetit dhe e programit të ditës dhe lutja e mëngjesores	0400	(R. Prog. Shtunës) Shpjegimi i fjalës së Zotit e cila na përgatit për të dielën – Don Preka.
07 ³⁰	Meshë të dielën, të mërkurën dhe të premten mesha është për bamirësit e Radio Marisë	<u>E Hënë</u>	
08 ⁰⁰	Rruzarja (për miqtë & bamirësit e RM)	0100	(R. Prog. Premtes) Zoti flet e ne dëgjojmë – Don Mark Shtjefni Fjala për të jetuar - Fokolarinët; Sakramentet mjet shëlbimi si dhe përse?- Orselina; Besoj shpjegimi i simbolit të fesë sonë - Orselina
08 ³⁰	Rruzarja (mërkurën dhe të premten)	0400	(R. Med. Enjte) Ritransmetimi i meditimit të ditës së enjte. Don Preka
08 ³⁰	Leximi i fjalës së Zotit dhe emisioni për të sëmurët, të moshuarit dhe ato që merren me punët e shtëpisë. Don Preka (Të hënë, të martën dhe të enjten)	<u>E Marte</u>	
09 ³⁰	30 minuta me fjalën e Zotit në dorë dhe në zemër	0100	R. Programi të mëngjesit të enjtes Leximi i Fjalës së Zotit dhe emisioni kushtuar të sëmurëve, të vetmuarve, të moshuarve dhe atyre që merren me punët e shtëpisë– Don Preka
10 ⁰⁰	Ritransmetimi i emisionit të orës 20 të ditës së kaluar	0400	(R. Prog. Të enjtes) Ne jemi mrekullia e Zotit – Motër Arta; Njeriu Pyet – Jolanda
11 ⁰⁰	Leximi i librit:	<u>E Mërkurë</u>	
12 ⁰⁰	Paraqitja e programit të ditës në vazhdim dhe lutjet Engjëlli i Zotit, ora e mesme dhe rruzarja	0100	R. mëngjesit e shtunë: Hap pas hapi në jetë – Domenika
13 ⁰⁰	Leximi meditativ i librit “Të përngjamët e Krishtit”	0400	(R. Mëngjesit e Hënë) Leximi i Fjalës së Zotit dhe emisioni kushtuar të sëmurëve, të vetmuarve, të moshuarve dhe atyre që merren me punët e shtëpisë– Don Preka
13 ³⁰	Ritransmetimi i emisionit për fëmijë (të hënave Ligjioni i Marisë)	<u>E Enjte</u>	
15 ⁰⁰	Kurorëza në nder të mëshirës Hyjnore dhe Shërbesa e leximeve	0100	(R. Prog. të hënës) Familja kishë shtëpiake – Don Gjovalin Simoni
15 ³⁰	365 Historitë e biblës - Antonio dhe Paola	0400	(R. Programi i mëngjesit e marte) Leximi i Fjalës së Zotit dhe emisioni kushtuar të sëmurëve, të vetmuarve, të moshuarve dhe atyre që merren me punët e shtëpisë– Don Preka
16 ⁰⁰	R. Leximi i Fjalës së Zotit dhe emisioni kushtuar të sëmurëve, të vetmuarve, të moshuarve dhe atyre që merren me punët e shtëpisë– Don Preka (Të hënë, të martën dhe të enjten). Të dielave emisioni atmosferë këngësh.	<u>E Premte</u>	
17 ⁰⁰	Presim telefonatat tuaja për të paraqitur falënderimet dhe njetet për të cilat do të lutemi në rruzare	0100	(R. I emisionit të rinjtë kërkojnë thesarin- Motër Miki
18 ⁰⁰	Lutja e mbrëmësore	0400	(R. Prog i të martës) Misteri i Hyjit në lutjen e Kishës – Don Dominiku; Dora e ngrohtë e familjes – Roza; Një vulë në histori – Linda & Edisoni
18 ³⁰	Rubrika: Letrat e dëgjuësve	<u>E Shtunë</u>	
19 ⁰⁰	Emisioni për fëmijë	0100	R. Programi i mëngjesit e marte Leximi i Fjalës së Zotit dhe emisioni kushtuar të sëmurëve, të vetmuarve, të moshuarve dhe atyre që merren me punët e shtëpisë – Don Preka (Orselina)
19 ³⁰	Presim telefonatat tuaja për të paraqitur falënderimet dhe njetet për të cilat do të lutemi në rruzare		
20 ⁰⁰	Emisioni sipas ditës përkatëse, të dielën Në udhëtim me Krishtin drejtë për së drejti me radion Katolike Detroit		
21 ⁰⁰	Rruzarja		
21 ³⁵	Leximi i Besëlidhjes së Re – Don Preka		
22 ¹⁰	Lutja e pasmbrëmësore dhe paraqitja e programit për ditën e nesërme		
22 ³⁰	R. Leximi i librit		
23 ⁰⁰	Ritransmetimi i emisionit të orës 20 sipas ditës përkatëse		

Lutja për Radio Marinë

O Zojë, drejtoj zgjedhjet tona jetësore, na mbështet në orën e provës që besnik ndaj Hyjit dhe njerëzve ta përballojmë më guxim të përvuajtur misterin e eterit që të arrimë mendjen dhe në zemrën e secilit person më shpallje të gëzueshme të Krishtit, Shpëtimtarit të njeriut. O Mari, yll i ungjillëzimit, ec së bashku më ne. Drejtoje Radio Marinë dhe jii pajtorja e saj. Amen.

Radio Maria Shqiptare
Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde

FREKUENCAT E RADIO MARISE

Në Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat:

FM 91.04 MHz;

Në Shkodër, Podgoricë, Ulqin:

FM 102.02 MHz.

Në Lezhë, Laç të Kurbinit:

FM 89.06 MHz;

- Në Pukë, Fushë-Arrës, Tropojë, Kukës dhe
Kosovë: FM 90.00 MHz.

Në Internet:

www.radiomaria.org.al



«Lajmëtari i Radio Marisë»
është organ i «Shoqatës Radio Maria»

Rr. 4 Dëshmorët Nr. 48

Tiranë ABANIA

Telefonat: Tiranë: 00355 42260466

Shkodër: 00355 22241808

Drejtor përgjegjës: Don Prekë Lazraj

Nëse më të vërtetë të pëlqen Radio Maria, mos harro ta mbështetësh edhe me ndihmën tënde financiare. Tregoju edhe miqve të tu që janë zemërgjerë që ta bëjnë të njëjtën gjë e ta mbështesin këtë vepër të mëshirës dhe të dashurisë të cilën Hyji ia bëri Popullit Shqiptar!

Si të jemi mirënjohës

Bamirësia fillon në shtëpinë tonë. Zëri i Radio Marisë arrin në shtëpinë tuaj njëzet e katër orë.

Është e vërtetë se prej jush kërkohen shumë ndihma, sepse në botë ka shumë njerëz dhe iniciativa të cilat kanë nevojë për ndihmën tënde. Zemra juaj do që t'i gëzojë të gjithë, dëshiron të ndihmojë mbarë botën...

Nëse ke mundësi bëje këtë gjë, por mos harro se Radio Maria Shqiptare është një vepër e Hyjit e cila u ndihmon pa asnjë dyshim të gjithëve, ajo është krijuar për të të bërë mirë edhe ty, është afër njeriut në vetmi, në sëmundje, në vështirësi dhe vazhdimisht e dhuron ilaçin e lutjes dhe të Fjalës së Hyjit.

Radha e drejtë e gjerave ju nxit që atë ta vendosni në vendin e parë, duke ia falur mirënjohjen e drejtë dhe kujdesin që Zëri i Hyjit të ketë mundësi të arrijë në secilën shtëpi, rrugë dhe ambient, në secilën ditë. Mos harro se Radio Maria nuk ka mbështetje përveç mbështetjes që ia jep ti me dhuratën tënde zemërgjerë. Kremtojmë Lindjen e Krishtit, ta shprehim mirënjohjen tonë! Shprehni mirënjohjen tuaj me lutje dhe apostullat për të përhapur Radio Marinë.

Lurdi i 1858-2008

Paraqitjet e Zojës së Bekuar ishin të mbështjella me dritë dhe Hyji deshi që në shikimin e Bërnardetës të ndezë një flakë, e cila ktheu nga Hyji njerëz të panumërt. Sa personat vijnë këtu për të parë, duke besuar në brendësi se do tu ndodh ndonjë mrekulli; pastaj gjatë kthimit në shtëpi, pasi kanë bërë një përvojë autentike shpirtërore të jetës, e shikojnë ndryshe Hyjin, të tjerët dhe vetveten. Një flakë e vogël që quhet shpresë, solidaritet, butësi, kujdes, tashmë banon në zemrat e tyre.

NDIHMONI RADIO MARINË NË:

BANKA INTESA SANPAOLO

LLOG LEKË: 1043631801

LLOG EURO: 1043631803

**PRO-CREDIT BANK
SHKODËR:**

LLOG LEKË: 600388970001

LLOG EURO: 600388970102

PRO-CREDIT TIRANË:

LLOG LEKË: 127837030101

LLOG EURO: 127837030002

Viti i Shën Palit

29.06.2008 – 29.06.2009

Ati i shenjtë na flet

Shën Pali dëshiron të flasë me ne – sot. Për këtë arsye desha të shpall këtë vit të veçantë “Vitin e Shën Pali” që është mësuesi ynë për ta dëgjuar dhe për të kuptuar sot nga ai fenë dhe të vërtetën”, në të cilat janë të rrënjosura arsyet e njësisë së dishepujve të Krishtit.

Në dritën e të gjitha letrave të Shën Palit shohim se si në udhën e tij të mësuesit të popujve u plotësua profecia që ia tha Anania në momentin e thirrjes: «Jo po, unë vetë do t'i tregoj se sa shumë do t'i duhet të pësojë për shkak të Emrit tim!» (Vap 9, 16). Vuajtja e tij e bënë të besueshëm si mësues të së vërtetës, sepse ai nuk e kërkon më interesin personal, lavdinë personale, pagesën personale, por angazhohet për Atë që na ka dashur dhe e ka dhënë vetveten për të gjithë ne. (Predikimi i Benediktit XVI më 28. qershor 2008)

**Gëzuar Kërshëndellat!
dhe Vitin e Ri 2009**